



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 167/ 2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga koalicioni LDK-AKR , kundër subjektit politik, lëvizja Vetëvendosje, dega në Pejë për shkak të vendosjes së posterit në hapësirat publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si i palejuar ankesa e koalicionit LDK-AKR.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.06.2017, të paraqitur nga koalicioni LDK-AKR me seli në Prishtinë , kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Pejë, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017,aktivistët e tyre kanë vërejtur posterin e Lëvizjes Vetëvendosje ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur posterat e saj në drunjte dhe njoftime për tubime në shesh .

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 .

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejushmërisë së apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të apelit gjeti se ankesa e parashtruar nga koalicioni LDK-AKR me seli në Prishtinë, ka njëjtësi subjektive, objektive gjendje të njëjte faktike me ankesën e parashtruar nga Instituti demokratik i Kosovës (KDI) me datë 05.06.2017 parashtruar kundër subjektit politik me numër protokoli Anr.51-2017, Lëvizja Vetëvendosje me të cilën është vendosur më datë 06.06.2017.Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se ankesa e parashtruar nga koalicioni LDK-AKR është çështje e gjykuar “res iudicata”.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e në pajtim më dispozitat e nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 167/2017 më datën 09.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare.